




30. 12. 2021

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14. 01. 2016, dhe konform nenit 29 të Rregullores së ARRU Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë qershor 2020, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifar të DT për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)



1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë (ARRU/UTSH-14/01/2022), për aktivitetet themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përfshihet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU do të monitorojë për së afërmi realizimin e investimeve kapitale të aprovuara me këtë proces tarifar, duke mos lejuar që buxheti i investimeve të përdoret për shpenzime tjera.
4. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të KRU "Prishtina" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 30 dhe 31 të Rregullores 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
5. KRU "Prishtina" sh. a. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë UTSH, tek secili Konsumator, në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën, faturës të konsumatorëve.
6. Lista e Tarifave për Shërbime, e aprovuar nga ARRU me këtë UTSH, duhet të publikohet nga KRU "Prishtina" sh. a., së paku në njërin prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në ueb faqen: www.arru-rks.org;
7. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
8. UTSH hyn në fuqi më 1 janar 2022 dhe vlen vetëm për vitin fiskal 2022 (01.01-31.12.2022).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRU

1 x 1 Departamenti i Tarifave

1 x 1 Kryeshefit Ekzekutiv të KRU-së



Hajrije Morina

Drejtoreshë e ARRU



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-14/01/2022

URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

KRU "PRISHTINA" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2022

1. Tarifat fikse dhe Tarifat Volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EUR/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujësjellësit (EUR/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura (EUR/m ³)
Shtëpiak	1	0.44	0.06
Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	2	0.67	0.13

2. Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

2.1 Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

Shënim:

1. Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (d.m.th. 10 EUR) do të paguhet kur inspektimi bëhet: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa vetëm për njërin shërbim.
2. Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç'rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: "Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit".
3. Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuarat përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.

2.2 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	15 mm	80.00	240.00	490.00
	20 mm	80.00	240.00	490.00
	25 mm	100.00	260.00	510.00
	32 mm	140.00	300.00	550.00
	40 mm	180.00	340.00	590.00
	50 mm	370.00	530.00	780.00
	65 & 75 mm	490.00	650.00	900.00
	80 mm	625.00	785.00	1,035.00
	100 mm	780.00	940.00	1,190.00

Shënim:

*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

***Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

2.3 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	160 mm	26.00	153.00	403.00
	200 mm	36.00	163.00	413.00
	250 mm	46.00	173.00	423.00
	315 mm	76.00	203.00	453.00

Shënim:

*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

***Aplikohet në rastet kur pusëta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

2.4 Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

2.5 Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	20.00

2.6 Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

3. Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

3.1 Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i ujëmatësit	Tarifa për ujësjellës (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	20 mm	16.50
	25 mm	16.50
	32 mm	16.50
	40 mm	18.00
	50 mm	18.00
	63 mm	18.00
	75 mm	19.00
	90 mm	19.00
	110 mm	19.00

Shënim: Kjo tarifë aplikohet konform nenit 28 të Rregullores 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.